



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të neneve 3.4 (i), 15.1 dhe 21.2 të Ligjit Nr 03/L-051 për Aviacionin Civil (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 28, 4 qershor 2008),

Me qëllim të vendosjes së kërkesave për zbatimin e Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë për ofruesit e shërbimeve,

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik të palëve të interesuara, në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2012 mbi procedurat për konsultim publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

RREGULLORE Nr. 1/2013 MBI ZBATIMIN E SISTEMIT PËR MENAXHIMIN E SIGURISË (SMS)

Neni 1

Fushëveprimi i zbatimit

1.1 Kjo Rregullore do të zbatohet nga ofruesit e shërbimeve të cilët janë të detyruar të vendosin një sistem të Menaxhimit të Sigurisë (SMS) në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO).

1.2 Kjo Rregullore paraqet një vështrim të përgjithshëm të kërkesave, qasjes dhe veprimeve themelore të detyrueshme për zbatimin e SMS. Ajo nuk ka për qëllim të ofrojë të gjitha kërkesat për një SMS, dhe nuk është zëvendësim i kërkesave të tjera mbi SMS që mund të kërkojnë sipas legjislacionit përkatës të BE-së, EASA-s apo akteve tjera të zbatueshme nënligjore që lëshohen nga AAC-ja.

1.3 Organizatat e miratuara të trajnimit të cilat u ekspozohen rreziqeve të sigurisë gjatë ofrimit të shërbimeve të tyre do të zbatojnë SMS, siç kërkohet me Aneksin 1 të Konventës së ICAO-s.

1.4 Operatorët e përfshirë në operime të transportit ajror komercial do të zbatojnë SMS-në, siç kërkohet nga Aneksi 6 i Konventës së ICAO-s, Pjesa I.

1.5 Operatorët e helikopterëve të përfshirë në Transportin Ndërkombëtar Ajror do të zbatojnë SMS-në, siç kërkohet nga Aneksi 6 i Konventës së ICAO-s, Pjesa III.

1.6 Organizatat e miratuara të mirëmbajtjes (AMO) do të zbatojnë SMS-në, siç kërkohet nga Aneksi 6 i Konventës së ICAO-s, Pjesa I.

1.7 Operatorët e përfshirë në operimet e aviacionit të përgjithshëm do të zbatojnë SMS-në, siç kërkohet nga Aneksi 6 i Konventës së ICAO-s, Pjesa II.

1.8 Organizatat e trajnimit të fluturimit (FTO) dhe Organizatat për trajnimin e miratimit të tipit (TRTO) do të zbatojnë SMS-në, siç kërkohet nga Aneksi 1 i Konventës së ICAO-s.

1.9 Ofruesit e shërbimeve të navigacionit ajror do të zbatojnë SMS-në, siç kërkohet nga Aneksi 11 i Konventës së ICAO-s.

1.10 Aerodromet e certifikuara dhe Heliportet do të zbatojnë SMS-në, siç kërkohet nga Aneksi 14 i Konventës së ICAO-s, Vëllimi I dhe II përkatësisht.

Neni 2 **Përkufizimet**

Për qëllim të kësaj Rregulloreje, përkufizimet dhe shkurtesat e përdorura këtu do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

Pranuar - do të thotë nuk është kundërshtuar nga AAC-ja, si e përshtatshme për qëllimin e synuar.

Miratuar - nënkupton që është dokumentuar nga AAC-ja, që jep autorizimin si e përshtatshme për qëllimin e synuar;

AAC - nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, të themeluar sipas Ligjit nr 03/L-051 për Aviacionin Civil;

Rrezik potencial (*hazard*) - nënkupton një gjendje, objekt apo aktivitet me potencial të shkaktimit të lëndimit të personave, dëmtimit të pajisjeve ose strukturave, humbjes së materialit, apo zvogëlimit të aftësisë për të kryer një funksion të përcaktuar;

Konventa e ICAO-s - nënkupton Konventën për themelimin e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil;

Zbutje- do të thotë masë e nevojshme ose për të shlyer rrezikun, ose për të zvogëluar ashpërsinë apo gjasat e rrezikut;

Rrezik - nënkupton vlerësimin, e shprehur në terma të probabilitetit dhe ashpërsisë së parashikuar të pasojave të një rreziku potencial, duke marrë si referencë situatën më të keqe të parashikueshme;

Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë (SMS) - nënkupton një qasje sistematike ndaj menaxhimit të sigurisë, përfshirë strukturën, përgjegjësitë, politikat dhe procedurat e

nevojshme organizative.

Ofrues i shërbimit – do të thotë një organizatë e cila ofron shërbime të aviacionit, duke përfshirë organizatat e miratuara të trajnimit që iu ekspozohen rreziqeve për siguri gjatë ofrimit të shërbimeve të tyre, operatorët e mjeteve ajrore, organizatat e miratuara të mirëmbajtjes (AMO dhe CAMO), organizatat përgjegjëse për dizajnimin e tipit dhe/ose prodhimin e mjeteve ajrore, ofruesit e shërbimeve të navigacionit ajror, aerodromet e certifikuar dhe furnizuesit e shërbimeve të trajtimit në tokë që u ekspozohen rreziqeve për siguri gjatë ofrimit të shërbimeve të tyre.

Neni 3

Dispozitat e përgjithshme

3.1 Të gjithë ofruesit e shërbimeve duhet të krijojnë, ruajnë dhe t'i përmbahen SMS-së që është i përshtatshëm për natyrën, madhësinë dhe kompleksitetin e operimeve të autorizuar për t'u kryer sipas certifikatës së vet si dhe rreziqeve dhe rreziqeve potenciale për siguri të ndërlidhura me operimet.

3.2 AAC-ja është përgjegjëse për pranimin dhe mbikëqyrjen e SMS-së së ofruesit të shërbimeve dhe për harmonizimin e kërkesave të SMS-së për tërë industrinë e aviacionit civil të Republikës së Kosovës.

Neni 4

Korniza e SMS-së

4.1 Udhëzimet e përgjithshme për zbatimin e SMS-së janë dhënë në Dok. 9859 - Manuali i Menaxhimit të Sigurisë (SMM) të publikuar nga ICAO.

4.2 Korniza e SMS-së e ofruesve të shërbimeve duhet të përfshijë katër (4) komponentët e mëposhtëm, të përbërë nga 12 elemente:

“1. Politika e sigurisë dhe objektivat

- 1.1 Zotimi dhe përgjegjësia e menaxhmentit
- 1.2 Përgjegjësitë e sigurisë
- 1.3 Emërimi i personelit kyç të sigurisë
- 1.4 Koordinimi i planifikimit të reagimit emergjent
- 1.5 Dokumentacioni i SMS-së

2. Menaxhimi i rrezikut të sigurisë

- 2.1 Identifikimi i rreziqeve potenciale (*hazardeve*)
- 2.2 Vlerësimi dhe zbutja e rreziqeve

3. Garantimi i sigurisë

- 3.1 Performansa e sigurisë dhe matja e monitorimit
- 3.2 Menaxhimi i ndryshimit
- 3.3 Përmirësimi i vazhdueshëm i SMS-së

4. Promovimi i sigurisë

4.1 Trajnimi dhe arsimimi

4.2 Komunikimi i sigurisë

4.3 Shpjegimi i zgjeruar i katër komponentëve të SMS-së, të referuar në paragrafin 2 të këtij neni, është në dispozicion në Dok. 9859 - Manuali i Menaxhimit të Sigurisë (SMM) të ICAO-s, dhe aktet tjera të aplikueshme nënligjore si dhe Publikimet Teknike dhe formularët që mund të publikohen kohë pas kohe nga AAC-ja.

Neni 5

Përshtatja e SMS-së

Të gjithë ofruesit e shërbimeve, të cilët tashmë kanë të vendosur një SMS që ofron më pak elemente sesa ato të referuara në nenin 4.2 të kësaj Rregulloreje, duhet të përshtatin SMS-në e tyre me dispozitat e atij neni.

Neni 6

Dispozitat kalimtare

6.1 Që nga data 1 shtator 2013, duhet të fillojë zbatimi i plotë i SMS-së nga të gjithë ofruesit e shërbimeve të referuar në nenin 1 të kësaj Rregulloreje, përveç atyre nga paragrafi 2 dhe 3 i këtij neni.

6.2 Organizatat përgjegjëse për Dizajn të Tipit dhe/ose prodhimin e Mjeteve Ajrore duhet të zbatojnë SMS-në siç kërkohet me Aneksin 8 të Konventës së ICAO-s, deri më 14 nëntor 2013.

6.3 Objektet e Regjistruara për Licenca Private të Pilotëve (PPL/RF) dhe Organizatat e Trajnimit për Pilotët e Glajderëve dhe Pilotët e Balonave duhet të zbatojnë SMS-në deri më 1 janar 2015.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 19 qershor 2013.

Prishtinë, 4 qershor 2013

Dritan Gjonbalaj

Drejtor i Përgjithshëm